

JORGOS BLLANAS

EPISODI

Shqipëroi: Vasil Çuklla

Gjirokastër • Athinë • 2013

EPISODI



JORGOS BLLANAS

EPISODI

Shqipëroi: Vasil Çuklla.

KRIMINELI!



Nga tavani, varret një llampë vajguri. Dritë e pakët, e bërë pis, e rrudhur, e pa rruar, bie mbi burrin, që mundohet të hapë rrugë përmes letrave, në tavolinën e një salle të paqënë. Duket i vdekur në vështrim të parë, varrosur në një piramidë vuatjesh varrur në dritare, që të mos lejojë të ikë pikëz drite nga shtëpia e rrënuar. Një kapotë ushtarake, është e flakur në tokë. Shenjat dalluese të së cilës, janë kaq të ngrëna, sa nuk dallohet, se kujt ushtrie i përket. Le që s'ka rëndësi. Bile, as që dikur, ka qënë student i Teologjisë. Rëndësi ka, që sot, akuzohet për krime lufte dhe i vetmi shok që kish, është larg, i sigurt, brenda çmendurisë së sprovës që ai kalon, që kur la Akademinë Ushtarake dhe u bë murg. Burri, i shkruan shokut të tij. Letrën, nuk e postoi kurrë. Por, veç kësaj, do të ishte krejt e pa mundur që letra të arrinte dikur tek marrësi. Burri, u gjend i vdekur. Është krejt e panjohur nëse e vranë, apo u vetvra. Miku i tij, ish vrarë ndërkohë, gjatë bombardimeve në manastir, një muaj më parë. Diku, në Ballkan. Natë.



Unë, Stefani, një pjellë dështake,
-lëndë e flakur, nga kushdo që më krijoi,
nga balta, apo ëndra, siç thonë...
frymëmarje e humbur, zëri, që gardhoj emrin tim,
në Parajsë, a në Ferr...
ish e vjetër pema,
nga ku preva dhe ndërtova, të përjetshmin
burgun tim, tmerr –
Kriminel, në luftë... dhe viktimë, në paqe,
me të njëjtin millef, të njëjtën dëshirë, të njëjtin përkushtim,
ndaj murgut të zot, Timote
dikur, i dashuri bashkluftëtar, Goran,
mik, në shkarjet e mija të vjetra
dhe sot, armik, për krimet e mia, ulërrim!
Po ke ndonjë ide, se çfarë mendon Zoti,
për gjëndjen ku kemi përfunduar,
të përgjërohem, më shkruaj, menjëherë.
Nuk do të desha, të më shikojë kështu,
krejt të pambrojtur, para Tij...
Por, po nuk ke... çfarë bën atje tej, në shkreti, ç'mendon?!
Kaq mospranues, u bëre ndaj jetës,
ti, që thuhej... se e dije mirë
çfarë bishe kundërshton çdo shpirt...
dhe, se sa gjak pushton në heshtje, trupin tonë?!
Kujto, një kopshtijë!
E, sa për ne,
vazhdojmë t'i besojmë, vetëm trupit,
të imponuar në një përzgjedhje, shkatërimtare,
diçka... si plagë-gjak, në fushën e betejës marrë.
Kujt gjëje, do t'i trembeshe më pak?!
Në fillim, është gjithmonë... rindërtim!
Shkulim fshatrat, njerin mbas tjetrit.
Pastaj... përbaltim, sillemi tek njerëzit e pambrojtur,
si ujqër të urritur. Do të hakmerren, besoj.
I shpaguajm paraprakisht, oh, mos e foll!...

duke i therrur, duke i vjedhur, duke u vetvuarë gjithë ditën
dhe natën mbijetojmë. Të përbrendshmet tona, vdesin
kur në të tjetrit, shtimë. Çdo kush gdhin
shumë kufoma, që të mos qajë të vetën.
Po, po!... Gjithkush, zgjuar rri!
Kërkojmë një burim dhe jemi të lindur, rërë.
Gjithsejçili bëhet, gjithmonë... dhe më njeri.
(Dhe shqipja, në krahët e sajë malor, shpreson një fund paqësor!)
Unë, nuk jam më ai, gjuetari që dije.
Kuptova, se i vdekuri, mungon përjetësisht.
Cilin mund të pyesësh, për këtë eklips të çuditshëm?!...
Kërkon, të ulërrish: " Duart e tij... duart e tij,
ku janë, duart e tij?!... është, pa të dy duart, ky fatzi!
ç'makabritet... ç'makabritet i pa përmbajtur!" sakaq mendon:
"Duart, e tijë... ato, të dy duart... jetime, pa njeri!"
Bëhet fjalë, patjetër, për një ndërvarje të sëmurë.
Ç'kuptim ka, nëse gjuha,
të therurrat e sajë, kërkon t'i varrosë
duke gërryer me duar, një dhe të fortë, si gurë?!
Ç'fituam nga kjo, shpirtargëtuese, liri?!
Spektatorë, kemi qënë. Linim krejt mënjanë,
ndjenjë dhe agoni. Kur dikush i shmangej
syrin të Kuçedrës, ulërrinim terrshëm,
a thua, se kupën humbisnim!... Marrëri!
Kafshë kemi qënë, hequr vizë,
në shkallët e arenës, përherë.
Pastaj, preja, për të rënë në lak, ka lerë.
Herë, kundërshtonte, si martire...
herë koha nuk e linte, as të gulçojë
nga tmerri, i të tmerrshmëve thonjë.
Villte frymëmarrjet, pa mëshirë.
Aty për aty, varrosej në vetvete,
para se të dorrëzonte panikun në sytë e sajë të dliërë,
djersën ndër duar,
vetflijimin, në buzë mbirë!
Ngrihemi brenda vetes, kërkonim të shikojmë,
se si gëlon vdekja, nga një dorëheqje,
të uritur ishin sytë tanë, kur veshët, e vranë etjen.
Zemrat tona, j'u a hapnim, bishave
me një nderim të thellë, vështrim të drejtpërdrejtë.
Dhe faleshim, për barqet e tyre,
lavdi të përjetshme!... medet!
Ulërrinim, dihatje të shpeshta,
fshikullonim mllëfin, të rridhte tërrbim.
Kërcisnim dhëmbët me mani, me qëllim,

copëtonim me buzët e thata shkrumb,
ç'ka mbetej nga preja, në arenë.
Kafshë në shkallët e arenës, ngërthyer vertetë,
shkallë erërrahur, shkallë djellëlarë, arena, e qelqtë!...
Sa dritë, mund të durojë
një rindërtim i shpejtë, i dëshpërimit?!
Shumë, shumë... një dorë e prerë.
Nuk të del koha, as gishtat të numërosh.
Në një çast, çast i çuditshëm, i ngjyer në ngjyr all
mendon: dhe po të tepëronin, dhjetë lugina bilbilash të errët...
dhe nëse mungonin, njëzet e katër hëna avlish që nuk flenë gjum?!
Si do të arrish në përfundim, se sa varfëri korre
duke mbjell gjakun tënd tek ky shkëmb,
që si palaço metafizik, ekuilibron në alogjizëm?!
Errësirë, errësirë dhe ne, refugjatë
në verbërinë forcrëndesë të plogështisë.
Në fund, dëshpërohesh,
e ndjen, veç si njeri mundesh të vdesësh,
dhe kurrë si gjethe. Por është natë
dhe qershitë, mbetur pas në fshat,
të ngjyejnë gjumin, zbukurojnë gjerdhe shtëpish,
që të kalojë i drunjtë, ai, zoti turist i fëmijërisë.
E njëjta erë e lashtë, e ndjek pas
me pemë, kaçube dhe me zogj.
Është një pamje. Jam dakord. Por, kur fillon, të bëhet e ëmbël,
e pret, e ha, e haron
ndër deje, ndër nerva, ndër eshtrat e tu,
ose i'a fal një krymbi! Ka gjasë...
Mirëpo, e fundosura, anija e tij
gjithmonë, trysni për së larti ushtron.
(Mos u mundo të shmangesh, tani që nisa të flas!)
Kjo që po jetojmë, nuk është bota vetë,
mbetjet e sajë kemi, ndër dhëmbë dhe ndër thonj.
Ndihe mi të zhgërryer, të pistë, por është e ngishme:
nejse, ngushëlluese, po qe se do të vdesësh
si ujk, pa dhëmbët që shqyejn!
Flasim, por i drejtohem vetvetes,
kaq vetmitarë në çastin e triumfit, si ka mundësi
kaq pak dorëlëshuar, ndaj stimujve tanë.
A thua n'a fotografon e njëjta histori,
në një teatër të zhbërë tani më,
për pak qindarka, për të fundit herë, gjithsesi.
Kam me vete, një foto të vjetër.
Nuk përshkruhet, sa i vendosur qëndron,
duke u munduar të qetësosh

shpirtrat, që këlthasin në sytë e tu,
pothuaj pa buzë, nga përpjekja...
pothuaj pa gishta, nga urrejtja.
Hë pra, çfarë pret?!

Si mundet t'ia dalë një Zot, me kaq vranësirë shpirtrash?!
Pakëz erë të fryjë, dëborë shkatërimi do të bjerë, ti e di!
Unë, një rresht më sipër, errësirë e plotë, brenda syve të mi,
që kurrë nuk e kuptova, për se kishin etje, për çfarë kishin uri
verbuar isha, brenda meje thellë, gjer në çmenduri.
Ti, diç mund të lexoje... diç lexove,
nuk e mësova kurrë: ish e pakët drita.
Në karahun tim, ajo, e çuditshmja, flatrare vajzë
strukur, në qershizat e buzëve të sajë,
duke soditur një zorkadhe dritë, në majën e ditëve tona.
Nuk të rrënoqethi ti, këngzogu i saj, Goran.
Timote, Goran, sa zogj ëndëroi mali përballë,
kaq degë kaçubet, të kishin, s'guxuan...
dhe sa brigje, i largëti det drithëroi,
kaq shkumë, as valët s'ëndëruan.
Po mendoj tani, përse kaq këmbgulje, nga ekualetimi plak,
për të n'a treguar një errësirë vertikale,
kur dita... digjej, në mbasmale?!

Pastaj, prehje... dhe e thellë, qetësi.
Të kujtohet?... Thoshja zvaranik, përgjigjeshe, skifter
Fle, vitepluhur, zvaraniku
dhe asfiksohet, për viteqiej, skifteri.
Çfarë prisnim, Timote, Goran?!

E pamë të rënduar, të ngarkuar dimër
dhe pastaj, në vrimën e tij të hyjë...
gjat orës së liturgjisë, të ngjisë
në trupin e të kryqëzuarit, një të pafundëm zhgënjim.
E çfarë do të fitonte, nga kjo ecejake?!

Një zot milingonë, në honet mishtorë
e Premte e Madhe! Çfarë po thoshja, Goran?!...
E varrosën, fshehtas.
N'a mashtruan, pikërisht në çastin kur kishim për të mësuar,
Çfarë s'ishte vdekje... ç'nuk ish' pavdekshmëri
unë, me vajzën zog... me Dekartin skifter, ti
gjumin e vetë, mjelmë, çdokush duke dëbuar:
një pafundësi shpresash, hemoragji,
duke ngjitur një mal, triumfi,
duke dëgjuar të vijnë me hap të rëndë, armëtuar,
duke ndjerë me gjunjë të zbresin, rrënjë punëtore.
Do të coptonin, të rrugëve, errësirë...
do të çanin barqe netësh, nga ndërtesat,

do të mbizotëronin, do të fitonin, do të triumfonin,
me forcë do të diktonin, pushtetin e shpirtit,
gurin e humbellës, këmbën e shpejtë të zhapikut,
krahun e zogut... mënxyrë!
"Rroftë pra, i jeshiluari, kapua i tyre, i pafytyrë!"
Kujtohu, Goran!... Pemët, Goran!
Ajo e lashta, e pyjeve demokraci,
e fëmijërisë monarki, në se ndryshonte, Goran?!
Gjak, nuk gëlonte, Goran?!
N'a fshehën tek vdekja, Timote, gjithshka ngjante me jetë...
a mos vallë, krejt e kundërta?!... Prej, frikës?!
Si mundesh të dish, se çfarë po kalbet
në plehravendin e dialektikës,
kur erë, Parajsë, mban një jasemin?!
Dhe ndërkohë, që ravijëzojmë figurën e zhvillimit,
që do të përmbushej, fal përpjekjeve të Zotit,
për të mësuar njerëzimin,
rrënonim, një shpresë,
për të mbrojtur, një trill,
në caqe rreptësisht të përcaktuara, mirë.
Jeta, nuk do të shpalosej më
mes dy elementesh, të paktën demonik.
Anijet, s'do t'i bënin ujërat, telef.
Velat, s'do t'a bënin të dihashte, të paskrupullën thellësi,
që ngitej me gjethe të bardha borë, drejt mëmëdheut
të së kaltërës, pavdekësi. Ndërkaq,
do të orientoheshin, drejt një deti të ndriçuar...
kurrë, drejt një deti që ndriçon,
apo, një të errëti det.
Do të vdisnin, brigje pafund,
ndërkohë, njolla të errëta do të mbinin,
sipër kodrave zhveshur, lakuriqësuar.
Majat, do të humbisnin, ndër shkëmbinj,
gurë dhe gëmusha, do të digjnin sytë
e kukuvajës perëndim. Qiparisë dhe pallate
sipërfaqe, s'do të shihnin, s'do të të jepnin përshtypje aspak,
se të gurta u ndërjuan, u vendosën këtu, kohë më parë.
Vetëm, metal, i etur për ndryshk,
krahë zogjsh korbëzinj, që të lenë pa gojë,
në një natë ballkanike, goditur nga një dashuri e paparë,
gjak i tërrbuar, alkolik, gjak valltar
dhe murgu Grek, që ulërrin:
"Të shpëtojmë çfarë të mundemi natën që zgjohet
një zot lubi, vet botën, ujk-njeri.
Pas pak haresa dhe zakoni, agon!"

Balta që ngjyen flokët atdhe, ende ekziston...
rrënjë të errëta, rrëmbejnë, shtrëngojnë një krif
që fllad, më nuk shpreson, por është erëmirë.
E djelë, rrepe dhe verë, limon vegimndjellës
në të bardhin fustan të nuses.
Vdekjen mendon, si përherë... dhe plaket kaq thellë.
Goran, Goran, po të flisja për jetën. Mos vall është
ky plaçkaxhiu shi, që doli
në xhiro kaq herët? Kuptohet, për të të lagur!...
Po të ishe këtu!
Po të lotoje me mua,
të tmerrshmet gjetje të tij:
lëkurën e një baxhe, që dikur ishte xham...
dy, tre gishtë skurje, në mendeshat e lashta,
një prehër hithra, të ngopura dërrasë të kalbur.
Nuk kupton më?!
Që të të bëjnë të vuash, shpikën shkencë të re,
"njerëzore", si vërshëllimë nepërke, mbi tehun e një brisku:
nxënësi, që lidh të vetën sandalle,
është një Patrokël, një Akil
dhe për më tepër, të nxehet, i paaftë.
Krishti, pa mjekër, nuk mund të krahasohet
në asgjë, me Zeusin edhe pse kjo nuk është,
e domosdoshme, aspak.
Dora e tij e djathtë, shtrihet në amëshim,
që të theksohet, i bekimit akt.
E gjatë dora, i madhë bekimi.
I madhë muri, e pafund kasaphana.
Shiko, arti ka në thelb, veprimin e heqjes, jo të shtimit.
Rrëmben nga natyra gjithshka, ndërsa më parë,
ëndëron dhe mendon thellë, se cili do të jetë përfundimi.
Është e vetmja rrugë, të ngjitesh për tek Zoti
duke bërë dhe ti, atë ç'ka Zoti bën. Por, nëse s'riprodhon
tiparet e përgjithshme,
thjesht, si fotograf?!... Shtiresht, derisa dikush,
të marrë përsipër dhe të organizojë, prodhimin.
Një lojë me kundërshtar, një natyrë krejt teknike,
ku njeriu të jetojë nën hije
makinash të mëdha.
Kopeja, mblidhet lehtë për mërzim.
Haron se çdo të thotë, dje, sot edhe nesër.
Ha, pi, tret dhe prapë rypërçyp.
Lumturia tanimë, nuk është më shpresë, është përndjekje.
Shqipëri gjumin,
që zhelet e ditës, të arnojmë!

Kush këmbnguli, për të famshmen, logjikë?!
Nga se të vuante, mjerani i shkretë?
Logjika, është detyrë e filozofisë,
që të mund të saktësojë, të qartësojë, idetë.
Filozofia, nuk është teori, është veprim.
Duhet t'i saktësojë rreptë, mendimit udhën,
shpesh do të thoshim, të turbulltit, të ngatëruarit,
mendim. A thua, të ketë qënë mirë!
Teologjia ka për synym, të sqarojë të pa perceptueshmen.
Pra, është teori, s'ka aktivitet, s'ka veprim:
tjetër kjo... "syhapur, teori".
Shkenca ka qëllim, gjithshka t'a shohë nga lart
dhe tmerrësisht e akullt, për to, të japë spjegim.
Ja pra, kështu plotësohet më së miri,
figura e Orlit grabitqar:
Çohem lartësisht, vërrej, turem.
Pastaj mendoj, të gjithë këtë ndërmarje...
në mbetjet skeletore të viktimës, kërkoj
atë fjalë imponuese, Jetë...
patjetër në gjyrë të kuqe! Çmendurisht, të kuqe, vërtet!
Zbulim, i mahnitshëm! Gjë tjetër, nuk kish çfarë të duhej,
veç, të prisje damarrët, në një çast të volitshëm...
pak më përpara, se të nisësh të perceptosh, idiotësi
në vend të detyrës. Je dakord, me mua?!
Pikërisht në çastin, që nis të dërgosh,
sa më shumë Pranvera, në kotjet e tua.
Në Shtator, rrushët, skuqen...
të zeza bëhen, prej tyre, disa.
Ç'dreq kuptimi, ka kjo,
nëse jo, një rrënqethje ëmbëlathët, në cepin e gjuhës?!
Kuptimi i një fjale, është shija e saj...
aroma, prekja, mania që ka,
copash t'i bëjë, pjaturinat e heshtjes
gjithmonë, gjithmonë pak më parë,
se tavolina, e së Djelës,
balta që ngjitej në këpucët tona në prag,
shiu ndër xhama, menteshat,
që nxeheshin dhe s'thoshin të hapen,
si grushta gardiane shtrënguar, për të fshehur
një gjysëm qindark,
me pantallona të shkurtëra, këpucët gjithë baltë,
dhe nga dritarja, zërat e gjyshes...
A kish kuptim, se në ç'gjuhë fliste?!
Kupto, Timote... Goran, si t'a duash, veç kupto!
Kishin ndërmarrë të n'a zhbëjnë, haptazi,

dy, apo tre valë njerëzish, veshur kreko.
U luta, u mundova të mos i gjykoj
me urrejtje të skajme... u mundova, cektinash dëshpërimi
të qëndroj. Veç, shpreha ndërkaq,
një keqardhje të thellë, asfiktike,
për dhunën dhe gjakderdhjen, që vinte ashtu, kot,
duke rrënqethur pleq, të pa strehë,
në stola parku, vitrina plot dritë, në parajsat
e një Zoti të pasur... që kurrë, s'ka pasur Zot!
Pothuaj, ulërrita, se diçka krejt e veçantë,
rrëshqet heshtazi, në jetën e njeriut paqedashës
një shkatërim, i të hershmeve mbaside të tij
në kopshte të lulëzuar, një gjetherrëzuar dëshpërim,
nga besim' i pa masë, në vlerën e kultivimit të praruar.
Eshtë e vërtetë, nuk ulërrita shpesh! Nga lufta e tregëtarëve,
askush nuk del i gjallë, Goran,
se kurrë nuk luftuan, për diçka të vetën.
Akoma dhe varfërinë, të gatshme e gjetën.
Si mundet që të njohin, të ujrave vërrshim,
kur çdo burim e fsheh, kaq mirë në pëshpërimë?!
Si të pranojnë tufanin, që një pemë
mundet ta lëvizë, me rrënjë, trung dhe degë?!
Si munden të dëgjojnë bilbilin, zog fatlumë
tek gdhin dhjetë gishta gjumi të coptuar,
në melodinë e zërit, të pagjumë?!
(Njeriu që hua ka marrë, dy duar është mjerim!
Njeriu, saraf... dy hapa zvaranik!)
Eshtë e pamundur të lejoja, atë
të pambuktën kasaphanë, që gatisnin në ëndra kërthije,
si grabitqarë liberalë, vjedhur nga një qyqe.
Nuk kish se si të heshtja, për atë
plastiken, luftë civile, që armatosnin në sy fëmije,
si gjarpërinj socialist, nga qifti të ushqyer.
Nuk kish përse të qaja për dy ara, sa gishti
dhe më pak...
për pesë a gjashtë shtëpi dhëmbëthyera, mbushur gjak!...
Kriminel, pra Goran?!
Unë, këtu poshtë, këlthita, vuajta të shtëpisë sime, Zot:
një gotë ngjyr zbardhëllyer verë, pak bukë, një batanije.
Mozartin, belbëzoja.
Isha i pa strehë, nuk isha Odise!
Timote... o vëllai nën Krisht, dezertori Goran!
Ti, ke vetëm një Parajsë, por unë thonjë, kam dhjetë!
Çfarë mundem të mas, me dhjetë thonjtë e mi?!
Dhjetë plagë të kahershme, pa vlerë

si trauma nga gurët, hedhur përmbi netë.
Mos m'u shmang edhe këtë herë!... Prit!
Djali është përherë, Zot' i mohimit.
Idhulldashuria verbale, tanimë është fe.
Idhulldashuria e kahershme, antike
desidemoni* është... të pëgërë, mbi çdo gjë biblike.
Një fshat kërkoja, pak ngrohtësi familjeje malësore.
Fetishi ka edhe ai pjesën e vet, në një vend të mbushur dritë.
Çfarë tjetër, të them?!... Mbeturinat e lëndës, mos i hidh në greminë.
Ndryshk përrenjtë, që ambicjen e drunjtë, ngijnë.
Njerëzit pikonin përherë mes nesh:
ide, plane dhe shpresë për ardhmërinë.
Do të kthehem në shtëpi. Më mirë se aty,
ku tjetër mund të shkoj, në një botë ngric, në një botë flak?!
Pas çmendurisë së erës, jo, jo, nuk vrapon më
ekualipti ynë, ekualipti plak!
Do të përpiqem, një tjetër të rris, një tjetër degëvogël.
Do të hap dritaren netëve, aromë të marr, të shpirtrave punëtore:
fëmijë që gdhendin kohën, me zëra të papritur,
grua që nuk ka veshur mbi trup, përveçse vesë,
e mbushur trëndafila, nga obori i vogël...
dhe qeni, errësirave t'ju lehë,
që vijnë, me hapa mjegullore...
dhe mace të përkëdhelen në të mijat duar,
miliona Zotër, në kotje perënduar!...
Ndërkaq, jam kaq i sigurt: më parë, vdes shpirti!

*Desidemoni = Frikë nga e epërmja, nga e Perëndishmja.



DEZERTORI!



Një qiri, pothuaj ulok nga pesha e flakës, mbush qelën me më tepër hije se dritë. Me gishta të pëçudnuar, tregon figurën e errët të një burri, që kërruset mbi një tavolinëz. Ngjan pothuaj i vdekur, varrosur brenda një qivuri antik, sa ç'është e gjithë bota e nëndheshme! Flakur përdhe, janë rasat e tij. I dikurshmi kryq i kuq, qëndisur në kapelen e murgut, është kaq i ngrënë, sa nuk e veçon dot më, formën. Nuk ka rëndësi. As që dikur kish qenë student, në Akademinë Ushtarake. Rëndësi ka, se prej kohësh tashmë, është murg... dhe se miku i tij i vetëm, tanimë është larg, duke u munduar t'i shmangët arrestit për Krime Luftë, nga koha që braktisi Teologjinë dhe u bashkua me radhët e forcave rrebele. Burri, i shkruan mikut të tij. Letra u gjend në rrënojat e manastirit , mbas bombardimit dhe burri i vvarë. Nuk arriti t'a postojë. Dhe veç kësaj, ish krejt e pamundur, që letra të arrinte, në destinacion. Miku i tij, u gjend i vdekur në strehimin e tij, një muaj më vonë. Nuk dihet nëse e vranë, apo u vetvra. Diku në Ballkan! Natë!



Unë Timoteu, shërbëtor i përlurur i Zotit...
dikur Goran, skllav i padenjë në vuajtjet e mija të athëta
i drejtohem, të paepurit Stefan, doras dhe viktimë
shpresash, të përbashkëta.
Vërtet jetova kaq shumë gjëra, që të di,
se si, të gjitha t'i haroj, fal eksperiencës:
Ditën, kur trupat, qëndrojnë horizontal,
ditë, serioze, e thjeshtë, efikase, e pa parë...
zenithin, e natës së shpirttrave
të paqëndrueshmen, të panjohurën, të rezikshmen natë...
drekën, ngujuar mbas gëmushës dritëlarë
dhe gurrit përvëltonjës, skifterin,
që akrobaton diçka të shpejtë si farë,
duke fshikulluar zhegun, duke provokuar shkëmbin,
duke eksituar pluhurin, ndoshta për të nënkuptuar
kaltërsinë, kripën dhe ujin. Ndoshta,
por në ndjesi, më të errëta, pothuaj të hekurta.
Kur njeriu, në të vërtetë, përbën shqetësim,
ikën, s'do t'ja dijë, ose... e lejnë pas.
Të tjerat, janë imtësi, shpikur me nxitim,
që çdo vendimmarrje, të pëlqyeshme t'a bëjnë,
nëmos të pranueshme. Tmerri, fillon shumë më vonë:
kur edhe zhgënjimi është pamundësi, e pa mohueshme.
Dikur, miqtë, do të humbisnin, në të horizonteve pafundësi
këmbngulës, qëndrueshëm, ngadalë,
derisa të mbetej vetëm, distancë dhe ftohtësi:
ajo bardhësi e mjegulluar, pluskim i së djeshmes
si leshterik gjithë vragë, që vjell bregut një valë.
E dija se nuk kisha për t'i parë më,
të paktën, jo mbi një liqen gjaku,
me vdekjen tek shëtit në atmosferë,
për të ngatërruar mes të panjohurish, frikë edhe tmerr,
për të ndërthurur dyshimin dhe durimin e kot,
shpirtligësinë, që gjithsejçilit i tepëron
detyrimisht, ose të paktën, nga që s'e shmang dot .

E dija, se asnjë çast dobësie
nuk më lejonte të kërkoja një remë
në të pruarin breg, asnjë furtunë
e fëmijërisë, nuk kish për të njohur në varrin tim pa meit,
asnjë nga të fundosurat anije të sajë, fëmijët
nuk do të lidhnin të shqetësuarat, konet e vogla
as çobenjtë, të mëdhenjtë, besnikët qenë.
Me mua, nuk do të nënkuptonin, asnjë breg
mbasi do të simbolizoja, cilindo, breg.
Nuk isha mik përvetësimesh, i vetëm, kam qenë!
Dhe më duhej i pagjumë të qëndroj...
të njoh, të tejskajshmet hije, që dritën konfirmojnë,
pak më parë se drita të shuhet, të shterojë...
të inspiroj, dyshimin njerëzor, pasigurinë njerëzore,
ligësinë njerëzore, në blunë e errët të natës,
sa që, kjo botë hiçe, vetëm me vesë të mbetej mbi supe,
vetëm me thonj në kyçe.
Kujtova, se shumë shpejt, do të triumfonte mbi trupin:
një vdekje e thjeshtë, e okërt, e rrafshët,
dhe jeta ime, do të haronte thellësitë, që lartësoheshin vertikalisht
gjithmonë dhe më shumë, para se të mendoj një val,
shumë më përpara, shumë më mbrapa, pak më pas
nga ç'pashë... dhe ndjeva... dhe u tmerrova prej mrekullisë,
i të qënurit vetëm fjalë, që në agoni flatrron,
kur dëgjon, të vetën fjalë!
Mendova shkëmbenjtë, të bartnin rrënjë imagjinare
deri në det, kaçubeve krejt të thata, sherr t'ju ndiznin
përmbi valë. E dinin mirë,
rrugën e vet... dhe veçonin nga stili:
dinin të ndërpusin në dritë, ç'ka tek gruaja, shtrihet
dhe ç'ka baret, tek burri, tek "fili".
Ç'ka lëviz në dorën, që prenë godet
dhe ç'ka qëndron, në tmerrin e ikjes.
E dinin mirë nga ku kthehej cilindo trup
kur ikte drejt atij, të argjillit det,
që vdekje është, prej dëshpërimit,
pa tesha dhe pa armatim, oh ç'më kanë parë sytë,
duke pirë ujë, çdo ditë të tretë,
duke ngrënë krip, çdo ditë të dytë,
shpresa, për të tmerrshmen kaltërsi, një tmerr i vërtet!
Atëherë, fjeta... ëndërova arogancën e një brezi.
Përpjekje e kotë! Krahu i pamat i plagës sime,
përfundimisht, të paafroshmes i përkiste:
një shtyrjeje, këmbëngulëse, një gërhitjeje,
më të skajëshme, se sa vetë një humbellë,

drejtuar përbrenda dhe nga brenda
e kuqe, e prehtë, e thellë!...

Dikush, erën trembte me një qiri të ndezur.
Monologonte: "E bukur ish dita, kur për të gjuar shkuam.
Pak më tutje vashat, duarfierat përkulnin,
në flladin e freskët... dhe linin ujin të shkruaj
këngë të përvajëshme: diku brenda, thellë...
më brenda dhe më thellë, në syqeni shkruar,
preja, e kuqe në cepin e gjuhës,
dhe këmba gjuhë peshku... lumi bërë, rrugë e praruar."
Monologonte, por nuk shkonte më larg
nga zemra ime, i vetëm, me një thëgjill në gojë:
skifter në pyll, gjarpër në hon.
Pastaj erdhi trupi... ujë edhe frym...
uji kërkonte kopshte, ndërsa fryma, zjarr.
disa fjalë: dhjetë gishta dhimbje,
vend: një det të banueshëm
q'i humbi valët dhe u bë, duar,
gishta, guva dhe thonj humnerë,
gjërat: zhele gjakmëkuar,
ngjarjet: ulërrima, rritur me heshtje,
kafshë të sakatuara ngarkese, që s'vlejnë as për të vrarë,
e megjithatë, me mospërfilljen e tyre transparente
sfidojnë, një dimër llahtarë.
Ku mund të zhdukesh, Stefan?!...
I tmerrshmi, Stefan...
zvaranik frikacak, i një triumfi të pluhurosur?!
Si mund të zvarritesha, në arenën e argumentit të tyre, gjakosur?!...
(Dhe përrua me luanë të ish, do të ndërronte gjë, do të kish vlerë?!)
Me çfarë t'i përballesh, dhunës së synimeve?!...
Përzgjedha pra, të dyshoj për çdo gjë të pastër, të pa përdhosur,
të plotë dhe jo të cungët. Përzgjedha unë "marshalli"
unë "trimi" të nënshtrohem,
në ngrohtësinë e heshtjes – të apatisë thuaj, po të pëlqen –
për të pohuar se koha tretet, konsumohet
që nga epoka, që vetë koha ka lerë.
(Eshtë gënjeshtër, gënjeshtër:
se koha lufton me morrat e veta,
që prej momentit, që qëlloi mes nesh
epidemia e shpresës, vetë jeta.)
U tërhoqa, tradhëtova, thanë... u tërhoqa them edhe unë, gjithsesi,
duke u zvarritur, duke fluturuar, s'ka rëndësi
e pohoj, rrefuzova të më ngarkojnë dhe disa shekuj
mizerjeje, vetëm dhe vetëm se do të mungoj.
Çfarë s'është gangrenë në gjuhë,

është plag e padurueshme, unë e di!
Dhe veç kësaj, kur ke kaq kohë nën pushtetin tënd,
botën, mund t'a dashurosh pari dhe nga e para
ose t'a harrosh, që në fillim.
Domethëniet, vdesin përditë, medet...
të pashpresa, shpërbëhen shpejt.
Nuk të del koha, t'i varrosësh.
Toka, mban erë heshtje asfiktike...
Përfundimisht, domethënie të reja shfaqen!
Fërkohen si të pazonja, nazike, në duart e tu
(veçanërisht duar njerëzish, mban mend?!)
të dorrëzojnë para këmbëve etjen dhe urin,
pikërisht, n'atë vend...
dedikimin e vakët, të qënurit jetim.
I ushqen me të njëjtën zbrazëti, që mijëra herë varrose.
Kur freskët bën, të mbështillen pranë gjithë kënaqësi.
Diç është edhe kjo, kur ke kaq shumë kohë dhe s'e gropose,
në dispozicion të zhbërjes tënde, për çudi!...
Çfarë mund të dija, për kordën këmbëngulëse, të gabimin e tyre?!
Bëhet fjalë ndoshta, për ulërrima akute,
aty ku asgjë, nuk i bën ballë ngasjes
(në tejgopje... gjithashu, mundet!...)
aty ku asgjë s'merr, vlerën e masës së vërtetë,
të formës, të thellësisë, të anulimit të vazhdueshëm...
ajo çka ish, të jetë... dhe nuk është dhe s'do të jetë...
dhjetë shekuj, Aristotel të përgjaken
dhe po kaq shekuj Mega Vasilësh, të infektojnë
një ftohtësi për së larti, një flakë për së brendshmi, të zjarrmojnë.
Sa pemë mbinë... dhe gjethe çelën, q'aherë?!
Sa gurrë, u zhvendosën?!... Sa rërë, nuk u mat?!
Një figurë, rrugëton njeriu,
padrejtësisht, tutet. Njeriu, i ngratë!
Pritet të ndjejmë dhimbje shpejt, pothuaj tani.
Stefan, thuaj si të duash, e ardhmja vonon...
zhvillohet, provohet... ti e di.
E shkuara ngre, gjithë peshën e realitetit,
që është dritëlarë, si gjethe... i errët, si rrënjë
dhe i papritur, si frut, apo vdekje. Mos o Zot!...
(Bekim i tmerrshëm, vërtet i tmerrshëm, të jesh gjallë, këtu posht!)
Endërojmë një orë, që të mbyllë,
llogarinë e hapur të çdo ore drithëruar,
në thellësinë e një zhgënjimi të praruar, të pa parë!
(Bekim i papranueshëm, të jesh aty lart, pronar!)
Por çfarë prek esencën, e të hedhurit në jetë?!...
Pranimi është njësoj, i zbrazët, si mospranimi

mospranimi, i zbrazët, si pranimi.
Vendimmarrja, nuk përbën asgjë në thelb
nuk të fal, të dish nga është drejtimi,
nuk zhbën më, as edhe një forcë,
nuk përbëhet më, nga dy fytyra,
të mund të konstatosh fytyrën tënde:
si sorkadhe e pa frkë, rrugës për në burim,
si njeri antik zixhirrlidhur, rrugës për në dritë.
Bota është tani, një botë e themeluar.
Njerëzit, e njohin njeri-tjetrin, bukuri...
dhe të gjithë së bashku, asgjë të kaltër apo jeshil,
të kuqe, të bardhë, apo të zezë, pak para se të gjëmoj flori.
Të ndjek pas, heshtja e një besimi,
që e braktisim dhe n'a braktis,
ndërsa ditët vazhdojnë të jehojnë shqetësim,
shekuj tani... shekuj, që tani.
Stefan, o kriminel i ëndrave, që ulërrinë shpirt
me mijëra fjalë, shpalosur
si gojëzogjsh, rënë në grackë!...
Stefan, o racë... zogu mishngrënës,
kalëruar mbi nxitimin, e krahëve të tij...
ç'farë mundeshim, saktë të vendosnim,
(... një Zot, e di!)
në një çast shqetësimi të paskrupullt?!
Me gjithë fuqin e shpirtit, do të drejtoheshim, drejt më të afërtës së ardhme,
të paktën, drejt një të ardhmeje të sigurt,
shumë-shumë, drejt një fitimprurëse, të ardhme.
Që të krijonim, duhej së paku, të besonim, do të thoja...
t'i zgjasnim dorën njeri-tjetrit dhe të ecnim. Në këtë rrugëtim,
mondanitetet e së djeshmes, do të përfundonin nevoja.
Realiteti, do të vraponte të fshihej në terr
edhe një herë akoma, siç duket, për të fundit herë!
Një figurë, rrugëton njeriu,
padrejtësisht, tutet. Njeriu!
"Por kjo, është tragjedi!", do të më thuash.
Dhe unë, të pyes: Çfarë njuh xhelati, prej plagës që shkakton?!
Rezultatin e kënaqshëm, të një dite të lodhshme,
shum – shum, disa njolla... të bezdisshme,
verbërinë e tij dhe shurdhërinë,
çmendurinë e hershme, të psherëtimave të veta
njuh, o vëllai im! Pra, çfarë kërkon?!...
Botën të mbyllur, në një çfarëdo ndërtim, zgavruar,
mbushur guva... dhe ushtarë të pa larë
skllëvër të përgjuar... dhe të uritur fshatarë?!
Duhet të n'a rrënojë, që në agim

nevoja e një të jashzakonshmi aktivitet,
duke rënë nga qielli, si kudhër e bronxtë,
rresht, nëntë ditë dhe nëntë, net?!
Duhet të n'a zgërlaqin
kanune të rrepta, më pak uniformë
sepse rrethanat janë të vështira
dhe gjendja e paqëndrueshme...
dhe jemi të detyruar, siç thonë,
metoda të reja të gjejmë dhe efikase,
që vdekjen nga pleqëria, të mbrojmë,
më parë se vdekjen, nga rinimi?!
(Kjo është, mos, o Zot, marrëria, harbimi!)...
Mos i godit mbretërit, përveçse, në kokë!
Për ndryshe, merru me sociologjinë institucionale,
elementin laboratorik, të tjerëve lejuja t'a sjellin
gjaku ngjyen vetëm, në fushën e luftimit!
Stefan, je tërrësisht i verbër?!...
Është e sigurt, çmimi i mosdijes, ka për t'u ngritur!
Nuk ka tjetër zgjidhje. Zgjidhja, është një
dhe e provokuam ne, "mëndjendriturit!"
Rritëm çmimin e habitës
që i pajisëm, po kështu
dhe çmimin e zgjuarsisë.
Blenin të vërtetën tonë, sade
e përpunonin dhe prapë n'a e kthenin
më shtrenjt, njënid fish. Vërejtje:
është e drejtë të paguajmë, më tepër
kam përshtypjen, për arogancën tonë...
le të themi dhjetë herë më shumë, me heshtje.
Ç'farë tjetër?!... Vem bast, që sapo lufta të mbarojë,
do të fillojë, kasaphana?!... Ushtria,
rebelët të kërkujë, ku fshihen...
të hyjë dhe të arrestojë, brenda shtëpive,
këdo që tenton të arratiset, në netë prrushe,
duke krijuar të Dantes ferr,
pas çdo gëmushe?! Njerëz, të pa armatosur,
të dynden në baxhat e bondrumeve,
që armët të zbrazin përmbi ta, roje të eksituar
nga era e një vdekjeje, të huaj.
Kaq të vdekur! Sa janë, nuk e dimë.
Le të mbetemi, tek e papërcaktuara, amani...
që të jemi, si gjithmonë, me ç'ka është thënë, të saktë
dhe të pasaktë, me domethënien. Stefan, Stefan...
tek gjaku, shkon çakalli, jo luani.
Të të vijë keq për veten dhe për mua

që shqetësohem dhe nuk mëshiroj veç lotët e mi
se, si i tillë baltosa duart e Zotit, o Perëndi!
Pas pak, qielli dhe toka, do të largohen të mpirë
në rrënqethjet e një flake, pa qiri, nuk ka as flakë.
Ku do të gjendet vend – po munde më thuaj –
për ata që u ngarrkuan, me kaq errësi?!...
Njësoj me demonët, ndoshta më të ligj
do të përfundojnë, të gatshëm, për cilindo dënim,
derisa të dalin nga ai, i vjetri zhgënjim
dhe të pastrohen në dritën e zhgënjimit të ri llahtarë,
që do të rrëfëhet kudo, në fshatra e qytete,
në lagje, në sheshe, me ikona dhe xheste,
me mimik, veç jo me me vepra, apo me fjalë.
Nuk e shikon, Stefan, se do të gjëndesh këtë herë,
ateist, ditën e besimit dhe besimtar, ditën e pabesisë,
duke vuajtur një Ferr, më të rëndë se ata,
që kurrë, nuk kanë njohur Ferr!
Heshtja e parë, është e imja... e dyta, të përket!
Pra, ruaja shtigjet gjuhës,
bëje gojën burg dhe leri jashtë viktimat...
Medet!...
Një botë e vendosur, nuk është botë, kurrë.
Bëju gati! Ke për të korrur,
kundërvajtjen e një lirie pafund,
që thotë skifter, kur zvaraniku vrapon
dhe thotë gjarpër, kur flak gurë.
Një figurë, rrugëton njeriu,
Padrejtësisht, tutet. Njeriu!
Vërtet, jetova kaq shumë gjëra, besoj.
Do të ngelem, me të plagës sime, gabim.
Mbarova! Prap shpirti hiqet zvarë, e dëgjoj.
Nuk kërcet, pëllcet. Nuk fshihet, qarrkon.
I duhem, derisa botën, të shpaguaj.

E DASHURUARA



Një glob i drojtur, rezervë... mundohet të ndriçojë të vetmen dhomë të apartamentit. Murret, janë plotësisht të zhveshur. As edhe një peisazh anonim, as edhe një foto dasme, nga ato me fytyra të ndryshkura dhe duar të djersitura. Në njerin nga të dy krevatet e drunjtë, shtrihet një i ri, i plagosur rëndë. Në tjetrin, një grua e re, e imët, e bukur si shi pranvere, pothuaj vajzë, ka mbështetur një bllok shënimesh mbi gjunjë dhe shkruan. Gishtat e dorës, mbajnë një stilograf, në mënyrë krejt aristokratike. Natyrisht, se kish qenë, studente e Psikologjisë. Ndërkaq, duken të tejlodhur. Po kështu edhe vështrimi i saj, tek shikon me llahtarë, të riun e plagosur. Buzët e sajë, të kuqe si qersh, tregojnë se duhet të jetë dashuruar shumë. Nuk ka rëndësi, se si u gjend e vetme në këtë dhomë të ndyrë, me një krejt të panjohur, pothuajse të vdekur. Rëndësi ka, se burri që vërtet dashuroi, me të gjithë fuqinë e shpirtit, kish qenë student i Teologjisë... dhe tani është i akuzuar për Krime Luftë. Atj i shkruan. Letra ra në tokë, u shkel, u gris dhe u copëtua, kur ushtria ja behu dhe zbrazi me ngut, kampin e refugjatëve. Ndërkaq, edhe sikur t'a kish postuar letrën, do të ish e pamundur të arrinte në destinacion. Fati i gruas, nuk njihet. Diku në Ballkan. Natë!



Sepse të dashurova si ëndër, me zjarre të panumërt
mbas kodrina malesh,
po të shkruaj, të fundit shkëndijë duke djegur,
unë ikja, e çuditshmja, e purpurt,
përvëlur, nga një hidhërim pa fund, i mekur!...
Mban mend?!... "Ikën si drenushë e përndjekur,
në shpëtofish si harabel, kjo është çudi!"
Mbijetova, si njeri q'është i vendosur,
të shpaguaj, të forcrëndesës, padrejtësi.
Nisa, ecejaket në qytet,
t'i ngre fole, pluhurit, të jetës që më mbet,
igrasisë... kotësisë, së jetës ibret.
Çdo gjë, më krijonte njëkohësisht, një përshtypje
rrënjosejeje... dhe një tjetër, që do të udhëtonte pafundësisht!
Shikoja përditë, të njëjtat shtëpi...
ngaqë e dija, që ishin të njëjtat,
i dashuroja këmbëngulshëm, me të njëjtin emër, natyrisht.
Pastaj ndjeva, se kisha sjellë me vete, më shumë
nga ç'kisha larë me lotë, a s'i arrita kurrë!
Shumë më vonë kuptova,
se të kisha pranë, në netët e rënda,
apo, isha krah teje – në një farë mënyre
kjo, përbën të njëjtën gjë,
nga një pikpamje tjetër, desh u çmenda.
Kujtoja, se trupi im, me tëndin nuk përputhen...
tani e di, mendohej të haronte, (lojë e vjetër)
atë etje, që ndizej brenda meje,
sa herë që i shuaja etjen, një trupi tjetër.
E kisha haruar veten, aty, në prehërin tënd
dhe ngaqë kurrë s'të përqafova, nuk dija çfarë duhej të kujtoja,
çfarë të kërkoja, çfarë të marr mbrapsht, apo të jap...
dhe le të mbetesha "asgjëja", që kurrë s'të dëshirova.
Shikoja, qiellin – sa shumë gjak,
ndër deje çova dëm, që të mundesha të shmang,
të kaltërtat gënjeshtër – e lija veten të varfërojë,

varfërinë e gjithkujt. Por është e pabesueshme, se sa ndryshojnë
njerëzit, në mënyrën se si shpresat, i flijojnë.
Pjesa më e madhe, vetkrijojnë: hamendësojnë,
ç'ka nga mendja u kalon, (medet!)...
mjafton të kapen dhe të shpëtojnë,
mbas së mbyturës, figurës së vet!...
disa, e pranojnë batakun në të cilin kanë rrënë,
a thua se e prisnin, që më në fund,
të ekzistojnë, si një e tërë.
Pastaj, erdhi zjarri të banojë
shtëpitë, që nuk i digjnin ata vetë,
nga një e paspjegueshme, vetpërmbajtje,
apo nga një, e pëligjur, kotësie ndjenjë.
Dhe ndërsa qyteti bëhej,
hi i mënxirtë, pa bilbila...
dhe sa kujtoheshin papritur,
se ende jetojnë, rrekeshin nga vdekja,
të tyren vdekje, të shpëtojnë...
unë flija një kopësht, mbushur me zymbyla.
Isha kthyer në shtëpi. Mbillje dy duar ekualipt,
inspiroja një gji mbasdite, të djelë...
mbushur shpirtra punëtorë dhe fëmijë dembel.
Pranvera vishja në darkë, drejt e në mish freski
të mbushur trëndfilë, nga e vogla avlli.
Kur më përqafove, gëlltita
dy kokërra të ëmbëltharta, qershi!...
E di, se ekualipti plak,
s'lufton më me erën...
as edhe unë, me ëndrrat e mia!...
Jam e sigurt: shpirti vdes,
kur humbet oborrin, që shpesh ëndërroi
nga gëzimi a pezmi, nga kotja...
nga moskëmbëngulja, a dashuria.
Shkurt!... E jotja!

I Ç'ARMATOSURI!



Një burrë, ecën në trotuarin e ngushtë. Një qen, ndjek hapat e tijë dhe herë- herë i kalon përpara. E shikon. Burri e dëbon, duke pëshpëritur gjithmonë të njëjtat, të dehurat, fjalë. Nuk është në dhe të vet, as shpreson të kthehet së shpejti. Nuk ka rëndësi. As që dikur ka qënë student në Institutin e Gjuhë – Letërsisë. Rëndësi ka, që mezi i shpëtoi vdekjes, në kampin e përqëndrimit të rrefugjatëve, ku e kishin çuar. Diku në Ballkan. Natë.



I huaj, në dhe të huaj, çfarë të them dhe çfarë të fsheh
rrethuar nga dyshimi, si guhak?!...
Më thuaj të paktën ti,
diç do të dish më tepër,
për këtë të tmerrshmin batak,
që vjen erë gjaku njerëzor, kur bie shi
dhe vjen erë shi, kur mbytet gjak!
Fol vetë, ose hesht! Mos më fol
për çudira, magji dhe për rengje!...
M'u hiq sysh, ik nga rruga ime,
mundem dhe i vetëm, këmbadoraz,
të zvarris, errësirën time!

Dholiana të Sipërme të Arkadisë – Athinë, 2001.